



Nr.02/643

Datë: 18. 11. 2020

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) neni 17 pika (a) dhe (c), dhe nenin 58 pika (h) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr 28/2008); Neni 24 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr.06-L-092; Nenin 29 paragrafi 5 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi Komunës së Shtimes, mori këtë:

PROPOZIM-VENDIM

PËR SHPALLJEN ME INTERES PUBLIK TË NGASTRAVE KADASTRALE NR.313/3, 313/4, 313/5 DHE 313/6, Z.K – DAVIDOVIC, PRONË E SALI BEQAJ – PETROVË

I

Kryetari i Komunës me shkresën Nr.02/643, datë: 18. 11. 2020, i propozon Kuvendit të Komunës së Shtimes miratimin e Vendimit për shpalljen me Interes Publik të Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Zona Kadastrale – Davidovic, Kultura: Kullosë e klasës së -I- . Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, me gjithsej sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, (10.248m²).

II

A r s y e t i m: Qëllimi i shpalljen me Interes Publik të Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Zona Kadastrale – Davidovic, Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, bëhet me qëllim të rregullimit të varrezave të fshatit, Parkut Rekreativ Sportiv, si dhe objete të tjera me interes publik, të cilat do ti parasheh, Plani Zhvillimor i Komunës.

Kryetari i Komunës
Naim Ismajli

